



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenor/Pridato Received/Delivery	27.11	2020	0	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shkronja Faqja Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPHSHCK	2809/2020		1/3	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.305/2020

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi–Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.305/2020, të datës 14.10.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], me adrese banimi fshati Gjonaj Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “mase disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.11.2020, mori këtë;

### V E N D I M

**I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.305/2020 e datës 14.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

**II. MBETET në fuqi** Vendimi me numër protokoll 0948 i datës 21.09.2020, i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ndaj Ankuesit [REDACTED] i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën „Zyrtar Korrektues”, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, me date 20.08.2020, Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prizren ka iniciuar procedure disiplinore me pretendimet se ankuesi supozohet se ka bere shkelje të rënda serioze të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 21.09.2020, ka nxjerr vendimin me numër protokoll 0948/2020, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „*ndalim i të ardhurave personale 20% e pagës për një periudhë një (1) muaj*” me arsyetimin që zyrtari korrektues ka kryer shkelje te rënde disiplinore .

Ankuesi [REDACTED], i pakënaqur me vendimin me numër protokoll 0948/2020 të datës 21.09.2020, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 12.10.2020, për mes postes së Kosovës, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar dhe protokolluar me numër 2090/2020 me datën 14.10.2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 22.10.2020 me numër protokoll 2214/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me



datën 03.11.2020 me numër protokollit 2415/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër A nr.305/2020, e datës 14.10.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 21.09.2020 i Komisionit Disiplinor; Ftese për seance i datës 21.08.2020; Forma e intervistimit e datës 01.09.2020; Forma e intervistimit e datës 01.09.2020; Forma e intervistimit e datës 25.08.2020; Forma e intervistimit e datës 24.08.2020; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 20.08.2020; Informatë e datës 19.08.2020; Libri i përcjelljes i datës 04.08.2020; Kontrata e punës e datës 25.07.2019; Përgjigje në ankesë e datës 03.11.2020, me numër protokollit 2415/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, pasi ka shqyrtuar shkresën e datës 20.08.2020, të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, me të cilën ka iniciuar procedure disiplinore ndaj ankuesit [REDAKTUAR] me pretendimet se ankuesi supozohet se ka bere shkelje të rënda serioze të detyrave të punës, ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitareve dhe provat e paraqitura, me datën 21.09.2020, me numër protokollit 0948/2020, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „*ndalim i të ardhurave personale 20% e pagës për një periudhë një (1) muaj*” me arsyetimin që nëpunësi [REDAKTUAR] ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe shkelje të parimeve e themelore të Kodit të Etikës neni 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, dhe 1.3, sipas Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 01 /2016 Kodi i Etikës Profesionale për Zyrtarët Korrektues në Shërbimin Korrektues dhe Rregulloren për menaxhimin e personave me rrezikshmëri të lartë.

Në bazë të shkresave të lëndës, është konstatuar që Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka arritur që në mënyrë bindëse dhe me prova konkrete konkretisht me regjistrimet e kamerave të provojnë fajësinë e ankuesit, dhe duke marr parasysh veprimet dhe mosveprimet e ankuesit, gjegjësisht pakujdesin dhe moskujdesin e ankuesit gjatë kryerjes së detyrës si kujdestar në krahun C në Qendrën e paraburgimit në Prizren, respektivisht gjatë daljes së krahut C në shëtitje ku është akomoduar edhe i paraburgosuri i rrezikshmërisë së lartë [REDAKTUAR], i cili në momentin e daljes në shëtitje dhe pas kthimit nga shëtitja ankuesi nuk e kontrollon gjegjësisht nuk ju kushton vëmendje të shtuara lëvizjeve të tij që është në kundërshtim me rregullat e përcaktuar në Rregulloren për menaxhimin e personave me rrezikshmëri të lartë. Ne baze te provave në lende konkretisht intervistës se ankuesit i cili deklaron „*se në momentin e daljes në shëtitje i paraburgosuri i rrezikshmërisë së lartë [REDAKTUAR] kishte një peshqir me veti, ndërsa pas kthimit të jem i singerte së nuk kam vërejtur diçka*” dhe sipas informatës së datës 19.08.2020, të lëshuar nga Mbikëqyrësi i Lartë në detyrë z, [REDAKTUAR], i cili po ashtu deklaron se pasi qe i kemi shikuar xhirimet e datës 04.08.2020 respektivisht ne kamerën numër 6 të krahut D, ne kemi vërejtur oficerin [REDAKTUAR] me një këse të zezë në dorë ku edhe ne kamerën nr, 14 shihet duke u ngjitur shkalleve të i paraburgosuri i kategorisë se lartë [REDAKTUAR] në dorë i vërehet një këse e zezë si dhe në kamerën 6, vërehet se si i paraburgosuri i kategorisë se lartë [REDAKTUAR] në korridor ja jep qesen një të paraburgosuri tjetër të dhomës qe ta fute ne dhome, ndërsa ky qëndron edhe pak në korridor deri sa oficeri e thërret për të shkuar në sallën e vizitave për të kontaktuar me SKYPE, pa përcjellje, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ankuesi [REDAKTUAR] me veprimet dhe mosveprimet e tij lidhur me përgjegjësinë ne punë si zyrtar Korrektues, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ka



vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se, **Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij” si dhe me nenin 25, paragrafi 2 të Ligji nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se. „2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i i Shërbimit Korrektues të Kosovës në rastin e shqiptimit të masës disiplinore „**ndalim i të ardhurave personale 20% e pagës për një periudhë një (1) muaj**”, me arsyetimin që nëpunësi [REDACTED] ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 06/L–114 për Zyrtarët Publikë dhe shkelje të parimeve e themelore të Kodit të Etikës neni 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, dhe 1.3, sipas Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 01 /2016 Kodi i Etikës Profesionale për Zyrtarët Korrektues në Shërbimin Korrektues dhe Rregulloren për menaxhimin e personave me rrezikshmëri të lartë, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 50 të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se **1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit**” dhe po ashtu masa e tillë është shqiptuar në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se „**Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj**”.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda Nr. A. Nr. 305/2020**

**Rushit Kajtazi**  
  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;;
- Arkivit të KPMSHCK-së